



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION

Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 43. Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.

Tel: +381 (0) 38 244 473

e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

KODI I SJELLJES

Në mbështetje të Nenit 20, alineja 1.11 të Statutit të FSHSK-së, dhe i harmonizuar plotësisht me Kodin Etik të Federatës Ndërkombëtare të Shenjëtarisë Sportive (ISSF), me propozim të Këshillit Drejtues, Kuvendi i FSHSK-së, me datë 11.11.2022, miraton:

KODIN E SJELLJES

I. QËLLIMI dhe FUSHËVEPRIMI

1. Me këtë Kod, përcaktohen parimet elementare të etikës, vlerat morale, normat dhe rregullat e sjelljes, të cilat do të zbatohen nga anëtarët dhe garuesit e FSHSK-së.
2. Dispozitat e këtij Kodi, do të zbatohen nga të gjithë anëtarët dhe garuesit e Federatës, të cilët kanë nënshkruar deklaratën e anëtarësimit në Federatë dhe pranimit të këtij Kodi.
3. Dispozitat e këtij Kodi, do të zbatohen edhe nga i gjithë personeli mbështetës, si dhe çdo person tjetër, që në saje të akreditimit, licencimit, ose marrëveshjes kontraktuale, ose në çfarëdo mënyre tjetër, është pjesë e organizimit dhe aktiviteteve të Federatës dhe/apo organeve, apo trupave mbështetës të Federatës.
4. Anëtarët dhe garuesit e Federatës duhet të marrin pjesë në themelimin, mbajtjen dhe zbatimin e standardeve të larta të sjelljes, kështuqë, integriteti individual, përkushtimi ndaj atdheut e kombit, ndershmëria, paanësia dhe puna e palodhshme, të jenë vlera me të cilat identifikohet çdo anëtar apo garues i Federatës.
5. Në tekstin e këtij Kodi, gjinia mashkullore nënkupton edhe gjininë femrore.
6. Për mbikëqyrjen e zbatimit këtij Kodi, është përgjegjës Komisioni Disiplinor i Federatës.
7. Është detyrë e çdo anëtari dhe garuesit të Federatës, që të njoftohet me Statutin, këtë Kod dhe çfarëdo akti tjetër të Federatës, në mënyrë që t'i respektojë dhe/apo t'i zbatojë ato si duhet. Mosnjohja e Statutit dhe Kodit, nuk e arsyeton anëtarin, apo garuesin, për çfarëdo shkelje të dispozitave të tyre.
8. Respektimi i rekomandimeve dhe vendimeve të organeve të Federatës, është detyrim për anëtarët. Refuzimi i anëtarit të Federatës në zbatimin e tyre, nënkupton heqje dorë e anëtarit, nga anëtarësia në Federatë.
9. Përgjegjësi i çdo klubi të Federatës, është i ngarkuar të kujdeset për zbatimin e këtij Kodi.

II. PARIMET E PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij Kodi është që të nxis mirëkuptimin dhe pranimin e parimeve themelore të sjelljeve sportive, si dhe zbatimin e tyre në kushtet e trajnimit dhe/apo garimit, nga ana e anëtarëve dhe garuesve të Federatës. Kodi synon të afirmojë dhe promovojë ndjeshmërinë ndaj vlerave që janë specifike për sportin e shenjëtarisë sportive, për anëtarët dhe garuesit e Federatës, në kuptimin më të gjerë, e të cilat nuk janë ende të rregulluara me ligj.
2. Pjesë e këtij Kodi, është edhe Rregullorja Anti-Doping, e miratuar nga Kuvendi i Federatës.
3. Identifikimi dhe përcaktimi normativ i standardeve të mirësjelljes është proces dinamik, i cili përcjell zhvillimin e vazhdueshëm të kuptimit të të drejtave dhe detyrimeve të qenieve njerëzore, të rregullave sportive në përgjithësi, si dhe të sportit të shenjëtarisë, në veçanti. Pikërisht për shkak të natyrës së tillë të normave të mirësjelljes, ky Kod i nënshtrohet rishikimeve të vazhdueshme dhe ndryshimeve të mundshme, në përputhje me zhvillimin dhe kuptimin e vlerave morale në rrethin specifik, në të cilin veprojnë dhe garojnë anëtarët dhe garuesit e Federatës.
4. Anëtari, apo garuesi i Federatës pajtohet se do të respektojë dhe do t'i ruaj këto vlera:

- a. Zbatimi i të gjitha normave ligjore dhe sportive, të aplikueshme në Kosovë dhe/apo në vendin në të cilin zhvillohen garat;
 - b. Zbatimi i rregullave anti-doping;
 - c. Zbatimi i vendimeve të organeve të Federatës, duke përfshirë edhe përgjegjësit e klubeve dhe reprezentacionit;
 - d. Ruajtja e traditës sportive dhe kultivimi i vlerave pozitive të sportit të shenjëtarisë, me qëllim të përcjelljes tek gjeneratat e reja;
 - e. Ndershmëria në jetë, në punë dhe në marrëdhënie me të tjerët;
 - f. Puna e palodhshme për përmirësimin e gjendjes së sportit të shenjëtarisë;
 - g. Përkushtimi dhe besnikëria ndaj anëtarëve dhe garuesve tjerë, si dhe ndaj Federatës.
5. Anëtari, apo garuesi i Federatës, do të ushtrojë gjithë respektin e mundshëm ndaj garuesve tjerë, e në veçanti ndaj garuesve dhe sportistëve më të vjetër.
 6. Të gjithë anëtarët dhe garuesit e Federatës, me sjelljet e tyre në familje, në klub, në vendet e trajnimit, si dhe në gara, do t'i përmbahen këtij Kodi, dhe do të veprojnë në mënyrë e cila i ka hije sportistit.
 7. Në çdo kohë dhe në çdo vend, anëtari, apo garuesi i Federatës, me të gjitha aftësitë e veta, do të ruaj dhe do të përparojë vlerat e sportit të shenjëtarisë, si dhe parimet dhe vlerat me të cilët udhëhiqet Federata. Anëtari, apo garuesi i Federatës, do t'i kultivojë këto vlera dhe parime edhe në sjelljet e tij jashtë klubit dhe sportit të shenjëtarisë, si dhe në përgjithësi në shoqëri.
 8. Anëtari, apo garuesi i Federatës, do të respektojë ligjet e vendit ku jeton dhe vepron. Ai do të jetë model i sjelljes sportive, në marrëdhëniet e tij me të tjerët. Në rastet kur ka nevojë, anëtari to të kërkojë sqarime, udhëzime, mbështetje nga përgjegjësit e klubit, reprezentacionit, apo Federatës.
 9. Anëtari, apo garuesi i Federatës, në çfarëdo pozite zyrtare të gjendet, do të kryej detyrat e veta me përgjegjësi të plotë, duke respektuar dinjitetin njerëzor të të gjithëve, pa bërë kurrfar dallimi, me kujdes të veçantë sidomos ndaj gjeneratave më të vjetra.
 10. Përveç të drejtave dhe kompensimeve që i takojnë si sportist, apo zyrtar, në asnjë rrethanë, anëtari, apo garuesi i Federatës, nuk do të orvatet të keqpërdor pozitën e vet, e as nuk do të mundohet të përfitojë favore nga të tjerët, për shkak të kësaj pozite.
 11. Ky Kod nuk merr përsipër të trajtojë çdo rrethanë të mundshme me të cilën anëtari, apo garuesi i Federatës, mundë të përballlet në angazhimin e tij, në sportin e shenjëtarisë. Kur gjendet në rrethana, në të cilat nuk ka qenë asnjëherë më parë, e për të cilat nuk ka ndonjë udhëzim të veçantë, anëtari, apo garuesi i Federatës, do të silllet duke pasur parasysh vlerat dhe parimet me të cilat udhëhiqet Federata dhe t'i zbatojë ato në rastin konkret.

III. DETYRIMET NDAJ FEDERATËS DHE ANËTARËVE

1. Çdo anëtar dhe garues i Federatës ka për detyrë t'i plotësojë detyrimet e veta ndaj Federatës, ta respektojë, ta ruaj dhe ta ngris autoritetin e Federatës dhe anëtarëve të saj.
2. Zgjedhja në organet e Federatës, është nder për secilin anëtar të Federatës. Anëtari mundë ta refuzojë zgjedhjen vetëm për shkaqe të arsyeshme.
3. Çdo anëtar dhe garues i Federatës është përgjegjës për veprimet e veta.
4. Organet dhe zyrtarët e zgjedhur të Federatës, janë përgjegjës për veprimet e tyre, sipas përcaktimeve në Statut, në Rregulloret përkatëse dhe në ligjet në fuqi.
5. Anëtari, apo garuesi i Federatës, do të respektojë çdo anëtar dhe garues tjetër të Federatës, organet dhe zyrtarët e Federatës, në përputhje me vlerat e përgjithshme njerëzore, parimet dhe qëllimet e Federatës, dispozitat e Statutit të Federatës dhe akteve tjera të Federatës.
6. Në çdo kohë dhe në çdo vend, anëtari, apo garuesi i Federatës, do të kujdeset dhe do të mbrojë interesat e Federatës dhe anëtarëve të saj, në përputhje me vlerat e

përgjithshme njerëzore, parimet dhe qëllimet e Federatës, si dhe duke respektuar ligjet e vendit ku gjendet dhe vepron.

7. Sa herë të jetë e nevojshme dhe në përputhje me mundësitë e veta, anëtari, apo garuesi i Federatës, do t'i ofrojë anëtarit, apo garuesit tjetër, mbështetjen e duhur, qoftë shpirtërore, apo sportive, sikur i takon një sportisti.
8. Çfarëdo mbështetjeje, do të ushtrohet në baza të rregullave të miratuara, si dhe duke zbatuar vlerat dhe parimet e Federatës.
9. Kur vëren shkelje të këtij Kodi, të Statutit, apo akteve tjera të Federatës, secili anëtar dhe garues i Federatës, e ka të drejtë dhe obligim, që ato shkelje, si dhe personat e përfshirë në ato shkelje, t'i paraqes për procedurë disiplinore para Komisionit Disiplinor.
10. Ankesë ndaj anëtarëve dhe garuesve të Federatës, mundë të bëjnë edhe palët jashtë Federatës, të cilët mundë të jenë të përfshirë nga pasojat e shkeljes së pretenduar të anëtarit, apo garuesit të Federatës.
11. Të drejtat e veta si anëtar dhe garues i Federatës, anëtari/garuesi do t'i ushtrojë vetëm në përputhje me Statutin, Rregulloret dhe vendimet e organeve të Federatës, këtij Kodi të Sjelljes dhe vendimeve të Federatës.
12. Kartela e anëtarësisë, që i jepet secilit anëtar dhe garues, shërben për identifikim vetëm brenda Federatës dhe si dëshmi se anëtari/garuesi ka kryer obligimet e veta ndaj Federatës. Kartela nuk mundë të përdoret për asnjë qëllim tjetër.
13. Për çfarëdo mospajtimi me ndonjë anëtar, apo garues tjetër të Federatës, anëtari/garuesi do t'i drejtohet Komisionit Disiplinor, me qëllim të gjetjes së zgjidhjes miqësore. Në asnjë mënyrë, anëtari, apo garuesi i Federatës, nuk do të përdorë mediet, apo format e tjera të komunikimit, me qëllim të arritjes së interesave brenda Federatës, apo për të shprehur ankesat/pakënaqësitë e tij, apo për të zbuluar informata, apo të dhëna lidhur me Federatën, apo anëtarët e saj.
14. Të gjitha veprimet e anëtarëve dhe garuesve të Federatës, duhet të kontribuojnë në përmbushjen e qëllimeve të Federatës dhe duhet të kujdesen për të mirën e anëtarëve të Federatës. Në këtë kuptim, nuk lejohet:
 - pengimi i qëllimshëm i aktiviteteve, të cilat Federata i ushtron, apo mbështet, me qëllim të realizimit të detyrave të përcaktuara;
 - çfarëdo veprimi (lobim, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit, etj) që ka për qëllim krijimin e pozitës më të favorizuar për ndonjë individ, apo grup në dëm të kriterëve objektive;
 - shfrytëzimi i pronës, hapësirave dhe të mirave tjera të Federatës, për qëllime personale, komerciale, politike apo fetare, pa miratim të veçantë shprehimor;
 - nxitja e anëtarëve tjerë të Federatës në mosrespektim të rregullave të Federatës, të cilat i dedikohen realizimit të qëllimeve të pranuarra të Federatës;
 - prezantimi i qëllimshëm i qëndrimeve personale si qëndrime zyrtare të Federatës;
 - shfrytëzimi i emrit, emblemës dhe/apo shenjave tjera të Federatës për qëllime personale apo veprimtari private.

IV. KONFLIKTI I INTERESIT

1. Anëtari, apo garuesi i Federatës, nuk do të ndërmarr veprime, me të cilët do të krijojë përshtypje se ai mundë të jetë i angazhuar në sjellje të cilat shkelin besimin e dhënë, në çfarëdo pozite qoftë, në Federatë, apo në jetën publike.
2. Anëtari, apo garuesi i Federatës, nuk do të lejojë që familja, marrëdhëniet shoqërore, ose marrëdhëniet e tjera, të ndikojnë në angazhimin e tij, qoftë në Federatë, apo jashtë saj, në mënyrë që nuk është në përputhje me vlerat dhe parimet sportive, me të cilët udhëhiqet Federata.
3. Anëtari, apo garuesi i Federatës, nuk do të përdor pozitën e tij, qoftë brenda Federatës, apo jashtë saj, për të krijuar përparësi, apo përfitime, për veten e vet, apo dikë tjetër.

4. Për të mënjanuar konfliktin e interesit, ky Kod, përcakton që, para marrjes së çfarëdo vendimi, nga i cili pritet të ketë përfitime materiale, apo jo-materiale, duhet të themelohet komision i veçantë, në të cilin nuk duhet të marrin pjesë personat të cilët mundë të kenë interes të drejtpërdrejt, apo të tërthortë. Çfarëdo komisioni që themelohet sipas këtij parimi, nuk duhet të ketë më pak se 5 anëtarë.
5. Personi i cili e din se ka, ose mundë të ketë interes të drejtpërdrejt, apo të tërthortë, duhet ta përjashtojë veten nga pjesëmarrja në komisionet e përmendura në paragrafin e mëparshëm.
6. Vendimet e komisioneve të përmendura në paragrafin e mëparshëm, do të bëhen të plotëfuqishme pas miratimit nga organet përkatëse të Federatës.

V. KOMUNIKIMI ME MEDIET APO ME PERSONA JASHTË FEDERATËS

1. Federata do të kujdeset për njoftimin me kohë dhe të drejtë, të të gjitha palëve me interes, për gjithë veprimtarinë e Federatës. Organet dhe zyrtarët e Federatës, do të kujdesen për zbatimin e parimeve të transparencës, si ndaj anëtarëve të Federatës, ashtu edhe ndaj opinionit publik. Të gjitha të dhënat, informatat dhe publikimet, do të bëhen dhe do të ruhen, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Federata ka rolin e vet sportiv dhe publik dhe për këtë, mbështet të drejtën e anëtarëve të Federatës për paraqitje para publikut dhe mediave, për shprehje të lirë të mendimeve dhe qëndrimeve të tyre personale përmes mediave, librave, revistave, etj. si dhe veprime tjera, me qëllim të së mirës së sportit të shenjëtariisë. Por, në çfarëdo paraqitje të tillë, anëtari, apo garuesi i Federatës, do të flas vetëm për veten e vet dhe për veprimet e veta. Ai, nuk do të diskutojë për çështjet, apo ngjarjet, në të cilat nuk ka qenë i pranishëm, ose të cilat kanë qenë jashtë përgjegjësisë së tij.
3. Kur bëhet fjalë për çështjet tjera që janë me rëndësi për Federatën, apo anëtarët e saj, e për të cilat organet e Federatës kanë marrë, ose duhet të marrin vendim të caktuar, Federata komunikon me palë jashtë Federatës, përmes personave të autorizuar. Në rast se kontaktohen nga mediet, apo kushdoqfotë tjetër, anëtarët dhe garuesit e Federatës, do të drejtojnë të interesuarit tek personi i autorizuar.

VI. TRANSAKSIONET FINANCIARE

1. Asnjë anëtar dhe garues i Federatës nuk është i autorizuar që të pranojë mjete financiare në emër të Federatës.
2. Në parim, Federata nuk do të pranojë mjete financiare në para të gatshme. Ky parim vlen për pagesën e anëtarësisë, kotizimit, apo licencimit, si dhe për çfarëdo transaksioni tjetër, duke përfshirë edhe donacionet, sponzorizimet, etj. Me qëllim të ruajtjes së transparencës, Federata do të publikojë të dhënat e llogarisë dhe parimet e kujdesit financiar, në mënyrë të përshtatshme.
3. Asnjë anëtar dhe garues i Federatës nuk do të bëjë fushatë për grumbullim të mjeteve financiare, për donacione, apo për çfarëdo forme tjetër të mbështetjes financiare, në emër të Federatës, pa autorizim të veçantë nga Këshilli Drejtues. Në rast të autorizimit përkatës, personi i autorizuar do të njoftojë palët e interesuara me të dhënat e llogarisë bankare të Federatës dhe në asnjë rast, nuk do të pranojë para të gatshme, në emër të Federatës.
4. Federata nuk do të pranojë kurrfar donacioni, apo mbështetje të drejtpërdrejt financiare, nga partitë, ose personalitetet politike.

VII. KUJDESI NDAJ PRONËS SË FEDERATËS

1. Asnjë mjet, pronë, apo pasuri, nuk do të blihet as të shitet, pa vendim të plotëfuqifshëm të organeve përkatëse të Federatës.
2. Anëtarët dhe garuesit e Federatës duhet ta ruajnë pronën e Federatës, të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë këtu dokumentacionin e shkruar dhe atë elektronik (duke

përfshirë pronën intelektuale) dhe të kujdesen që ato të përdoren në mënyrë të drejtë dhe efikase.

3. Anëtarët dhe garuesit e Federatës, nuk duhet të lejojnë që prona e Federatës, të përdoret për qëllime tjera, përpos asaj që i është përcaktuar me rregulloret e Federatës. Detyrimi për ruajtjen e pronës së Federatës përfshinë edhe kujdesin ndaj dinjitetit të Federatës dhe anëtarëve të saj.
4. Të dhënat personale të anëtarëve të Federatës janë konfidenciale dhe vetëm për përdorim të brendshëm në Federatë. Ato nuk mundë t'i zbulohen personave të tretë, pa vendim të Këshillit Drejtues dhe pa pëlqim të personit, apo personave, për të cilët vlejné ato të dhëna.

VIII. AKTIVITETET E FEDERATËS

1. Anëtari, apo garuesi i Federatës, ka për detyrë të marr pjesë aktive në organizimet e Federatës, sa herë që kjo të jetë e mundur, duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike dhe mundësitë ekonomike dhe të kontribuojë në punën e suksesshme të Federatës.
2. Anëtari, apo garuesi i Federatës, nuk do të jetë pjesë, e as nuk do të mbështes, ndonjë organizatë, ngjarje, aktivitet, fushatë, iniciativë, apo person, të cilët qoftë në të kaluarën, apo tani, janë në kundërshtim me parimet themelore, apo vlerat sportive e morale, mbi të cilat udhëhiqet Federata.
3. Anëtari, apo garuesi i Federatës, nuk do të jetë pjesë, e as nuk do të mbështes, ndonjë organizatë, ngjarje, aktivitet, fushatë, iniciativë, apo person, që do të shkilnin të drejtat dhe interesin, apo do të njollosnin reputacionin e Federatës, apo dinjitetin e anëtarëve të saj, të drejtat e njeriut, apo ligjet e vendit.
4. Në çfarëdo aktiviteti të organizuar nga Federata, ose ndonjë organizatë/institucion tjetër, anëtarët dhe garuesit e Federatës do të:
 - a. trajtojnë të gjithë sportistët me respekt, mirësjellje dhe konsideratën e duhur, në veçanti më të vjetrit;
 - b. trajtojnë pronën dhe ambientin me respekt, mirësjellje dhe konsideratën e duhur;
 - c. mbajnë veshjen e duhur dhe të dinjitetshme;
 - d. kryejné detyrat e tyre me tërë kujdesin dhe vëmendjen e duhur;
 - e. njoftohen me çfarëdo rendi shtëpiak, apo rregullore, të cilën duhet zbatuar gjatë kohës sa zgjatë aktiviteti, ose sa është i pranishëm në atë aktivitet, ose hapësirë;
 - f. kujdesen që personat të cilët janë nën kujdesin, ose mbikëqyrjen e tyre, do të zbatojné të gjitha obligimet e sipërpërmendura;

IX. AKTIVITETET JASHTË FEDERATËS

1. Federata nuk do të kryej asnjë aktivitet politik. Anëtarët dhe garuesit e Federatës, janë të lirë që të shprehin qëndrimet dhe bindjet e veta politike, ose të jenë anëtar të partive politike, përderisa këto veprime janë në përputhje me Statutin e Federatës, këtë Kod dhe me vendimet e organeve të Federatës.
2. Anëtari, apo garuesi i Federatës, nuk do të favorizojë pikëpamjet e tij politike, apo anëtarësimin e tij partiak, brenda Federatës. Në rastin kur merr pjesë në aktivitete politike, anëtari, apo garuesi i Federatës, nuk do të prezantohet, e as nuk do të flas në emër të Federatës.
3. Anëtari, apo garuesi i Federatës, në cilësinë e ekspertit, mund të angazhohet si këshilltar, bashkëpunëtor, anëtar i ndonjë organi ligjvënës, trupave profesionale, grupeve të punës me karakter qeveritar dhe joqeveritar, në organizata humanitare, organizata për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, këshillave botuese, anëtar, apo këshilltar në ndonjë organizatë për ofrimin e njohurive profesionale, etj. me kusht që kjo të mos jetë në s'përputhje me Statutin e Federatës, këtë Kod dhe/apo me aktet tjera të Federatës.

X. SJELLJET TJERA TË NDALUARA

1. Ndikimi, ose tentim-ndikimi, në anëtarët, organet, apo trupat tjerë të Federatës, në mënyrë që nuk është në përputhje me Statutin e Federatës dhe/apo këtë Kod të Sjelljes. Ndikimi, ose tentim-ndikimi, do të përfshijë, por nuk do të kufizohet: ndërhyrja, ose tentim-ndërhyrja e qëllimshme në punën, ose aktivitetin e anëtarit, organit, apo trupës së Federatës, dhënia e të dhënave të rrejshme, frikësimi, apo tentim-frikësimi i ndonjë anëtari, ose dëshmitari të mundshëm, etj.
2. Bashkëfajësia: asistimi, shtytja, nxitja, ndihma, komplotimi, mbulimi, mosparaqitja, apo çfarëdo lloj bashkëfajësie tjetër, e qëllimshme, që ka të bëjë me këtë Kod të Sjelljes, Statutin, apo aktet tjera të Federatës, apo ligjet e vendit, e kryer, ose në tentativë, nga ndonjë anëtar dhe garues i Federatës.
3. Fakti që një sjellje, ose veprim, nuk është përmendur si i ndaluar, në këtë Kod, nuk do të thotë se është i pranueshëm. Çdo person, i cili është subjekt i këtij Kodi, do të zbatojë maturinë dhe kujdesin e duhur gjatë çfarëdo ndërveprimi personal, shoqëror, profesional, apo zyrtar, në mënyrë që, sjelljet dhe veprimet e tij, të jenë në përputhje me vlerat dhe parimet e Federatës dhe/apo rrethit në të cilin gjendet.

XI. NDRYSHIMET DHE HYRJA NË FUQI

1. Ky Kod mundet të plotësohet dhe/apo ndryshohet sipas procedurës së përcaktuar në Statut të Federatës.
2. Ky Kod hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Kryetari i Federatës.
3. Për çdo ndryshim/plotësim të Kodit, Shërbimi Profesional i Federatës do të njoftojë degët e Federatës dhe do të kujdeset që të gjithë anëtarët, të marrin njoftimin, në kohën e duhur.

Prishtinë 11.11.2022
Kryetari i FSHSK-së
Gëzim Hazrolli

